



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije - Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
KOMISIONI I PAVARUR PËR SHQYRTIMIN E MATERIALEVE MËSIMORE NË GJUHËN
SERBE**

NUMËR: 37/2009

DATË: 2009

Mbështetur në nenin 93. paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 12 dhe 13 të Ligjit mbi arsimin në komunat e Kosovës, si dhe të nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të Komisionit të Pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe (KPSHMMGJS) për përdorim në territorin e Republikës së Kosovës të themeluar me datën 24 prill 2009.

Neni 2

Themelimi

1. Me këtë UA caktohet mandati i KPSHMMGJS për një periudhë një (1) vjeçare prej dhjetorit 2009 deri në dhjetor 2010.

Neni 3

Përbërja e komisionit

1. KPSHMMGJS të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, përfshirë:
 - 1.1. Tre (3) anëtarë të përzgjedhur nga MASHT,
 - 1.2. Tre (3) anëtarë që përfaqësojnë anëtarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të cilët mbajnë vende të rezervuara ose garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe
 - 1.3. Një (1) anëtar ndërkombëtar i përzgjedhur nga dhe që përfaqëson Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO/ZCN).
2. Kryesimi i Komisionit do të jetë me rrotacion, për çdo vit, në mes të një përfaqësuesi të përzgjedhur në mesin e anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe një përfaqësuesi të zgjedhur nga MASHT-i.
3. Secili anëtar i KPSHMMGJS -së nënshkruan kontratë me MASHT-in, e cila konfirmon se ata janë anëtarë ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë.
4. Palët nënshkruese të kontratës mund ta shkëpusin kontratën para përfundimit të saj, pasi të kenë informuar palën tjetër tridhjetë (30) ditë përpara. Zëvendësimi i një anëtari i cili e shkëput kontratën bëhet nga mesi i anëtarëve të institucionit nga i cili ka qenë anëtari që e ka shkëputur kontratën.

Neni 4

E drejta për të qenë anëtar

1. Anëtarët e KPSHMMGJS -së nuk duhet të kenë qenë të dënuar penalisht dhe duhet të kenë të drejtë të punojnë në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Pagesat

1. MASHT-i i kompenson anëtarët e KPSHMMGJS -së për punën e tyre, në baza mujore.
2. Norma e kompensimit është përcaktuar nga MASHT-i.

3. Anëtarët e KPSHMMGJS-së marrin paga të barabarta për punë të barasvlershme, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, fetare, politike, kombëtare ose etnike.
4. Nëse cilido anëtar i KPSHMMGJS-së nuk i kryen detyrat e tij/saj në përputhje me këtë UA, ai/ajo nuk do të ketë të drejtë të marrë kompensim siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 6

Struktura organizative

1. KPSHMMGJS ka sekretar/e. Sekretari/ja do të jetë përgjegjës për ofrimin e tërë përkrahjes logjistike, administrative dhe teknike, dhe për mbledhjen, shpërndarjen dhe arkivimin e të gjitha materialeve dhe dokumenteve që do të përdoren dhe zhvillohen gjatë punës së Komisionit.
2. KPSHMMGJS formon nën-komisione dhe grupe punuese, sipas nevojës.
3. Anëtarët e nën-komisioneve dhe grupeve punuese të paraparë në nenin 6 pika 2 caktohen nga KPSHMMGJS dhe paguhen për punën e bërë sipas marrëveshjes.
4. Nën-komisionet i kryejnë detyrat e dhëna nga KPSHMMGJS, në përputhje me të gjitha aktet ligjore në fuqi.
5. Komisioni do ta ketë selinë në Prishtinë, por anëtarëve do të mund t'u kërkohet që të udhëtojnë nëpër komuna të tjera.

Neni 7

Obligimet dhe përgjegjësitë

1. Komisioni ishqyrton materialet mësimore (kurrikulumet, tekstet shkollore dhe materialet tjera) aktuale që përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit që e kanë gjuhën serbe gjuhë të mësimdhënies për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin relevant në fuqi në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Gjatë kryerjes së të gjitha aktiviteteve të tij, Komisioni merr parasysh praktikën e mira të Bashkimit Evropian rreth materialeve mësimore, parimet dhe vlerat e Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës, kurrikulumet që zbatohen në shkollat e Kosovës, dhe vlerat që përmban Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës.
3. Komisioni harton rregulloren e punës së tij.
4. Komisioni harton një plan të hollësishëm veprimi, përfshirë koston e paraparë të të gjitha detyrave dhe aktiviteteve.
5. KPSHMMGJS i raporton mbi punën e tij ministrit të MASHT-it dhe Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN) çdo gjashtë (6) muaj, dhe do t'u dorëzojë atyre një raport të shkruar në baza vjetore.

Neni 8
Vendimmarrja dhe metodat e punës

1. KPSHMMGJS i merr vendimet me anë të shumicës së votave.
2. KPSHMMGJS mbledhet të paktën një herë në muaj, gjatë vitit të parë të funksionimit të tij, dhe të paktën një herë në dy (2) muaj, gjatë viteve në vazhdim.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij U.A. shfuqizohet U.A. nr. 35/2009 dt. 10.11.2009.


Enver Hoxhaj, ministër